

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 32645/16
Hajro ÇINI dhe të tjerët
kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 23 shtator 2025, si Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *President*,

Darian Pavli,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelar i Seksionit*.

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 32645/16) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa") më 6 korrik 2016 nga kërkuesit e listuar në tabelën bashkëlidhur ("kërkuesit") të përfaqësuar nga z. A. Muka, avokat i licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar për kërkesën qeverinë e Shqipërisë ("Qeveria") të përfaqësuar nga Agjenti z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

parashtrimet e palëve;

faktin që qeveria britanike, gjermane, greke dhe italiane nuk kërkuan të ushtronin të drejtën e tyre për të ndërhyrë (neni 36 paragrafi 1 i Konventës dhe rregulli 44, paragrafi 1, i Rregullores së Gjykatës);

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Kërkesa ka të bëjë me mosekzekutimin nga autoritetet të dy vendimeve administrative, të cilat njohin të drejtat e trashëguara të kërkuesve mbi dy parcela toke dhe të drejtat e tyre për kthimin e parcelave.

A. Informacion i paraqitur nga kërkuesit

2. Më 25 dhe 27 qershor 2008, Agjencia rajonale e Vlorës për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave ("Agjencia"), njohu të drejtat e trashëguara të kërkuesve mbi dy parcela toke në Sarandë dhe urdhëroi kthimin e tyre. Më 9 dhe 29 mars 2012, Gjykata e Rrethit Sarandë nxori urdhrat përkatëse të ekzekutimit. Më 16 prill 2012, kërkuesit e paraqitën çështjen te një përmbarues që të bëhej regjistrimi i titujve të pronësisë. Më 18 prill 2012, zyra përmbarimore filloi procedurën e ekzekutimit dhe i kërkoi zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme ("ZRPP") që të bënte regjistrimin e titujve të pronësisë së kërkuesve.

3. ZRPP-ja refuzoi në mënyrë të përsëritur regjistrimin e titujve të pronësisë, duke iu referuar vështirësive për caktimin e kufijve të parcelave, me pretendimin që vendimet e Agjencisë së Pronave nuk ishin mjaftueshëm të qarta në këtë drejtim.

4. Më 26 shkurt 2016, një task-forcë e Kryeministrit nxori një urdhër pezullimi në lidhje me parcelat në fjalë.

5. Më 27 shtator 2016 ZRPP-ja informoi kërkuesit që ishte akoma në pritje të udhëzimeve nga zyra qendrore për regjistrimin e titujve në fjalë.

6. Bazuar në paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës dhe nenin 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, kërkuesit u ankuan për shkelje të së drejtës së tyre për pronë, si pasojë e moszbatimit të vendimeve të Agjencisë në vitin 2008. Më tej ata u ankuan për kohëzgjatjen e procedurës së ekzekutimit. Sipas nenit

13 të Konventës, ata pretenduan që nuk kishin zgjidhje efektive për të trajtuar mosekzekutimin e titujve të tyre.

B. Informacion i paraqitur nga Qeveria

7. Ndërkohë, sipas informacionit të dhënë nga Qeveria në parashtrimet e saj të 19 marsit 2025, më 5 shtator dhe 20 nëntor 2008 përkatësisht, vendimet e Agjencisë të 25 dhe 27 qershorit 2008 u shfuqizuan dhe u kthyen për rishqyrtim nga e para nga zyra qendrore e Agjencisë në Tiranë. Kërkuesit nuk i kundërshtuan këto shfuqizime.

8. Më 2 korrik 2013, Agjencia vendosi të rrëzojë kërkesën e kërkuesve për njohjen dhe kthimin e pronave të paraardhësve të tyre. Një nga kërkuesit, Suzana Isufaj, filloi proces gjyqësor kundër atij vendimi. Më 3 qershor 2015, Gjykata e Rrethit Sarandë e pranoi atë padi pjesërisht.

Më 5 nëntor 2015, ai vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë. Më 6 nëntor 2024, Gjykata e Lartë vendosi të kthejë çështjen në Gjykatën e Apelit për një shqyrtim më të detajuar të titujve të pronës së paraardhësve të kërkuesve mbi parcelat, vendndodhjen e tyre të saktë dhe gjendjen aktuale të parcelave në fjalë. Duket se këto procese janë duke u zhvilluar akoma.

VLERËSIMI I GJYKATËS

9. Qeveria i kërkoi Gjykatës që të shpallë kërkesën të papranueshme për abuzimin me të drejtën për kërkesë. Ajo theksoi që kërkuesit nuk e kishin informuar Gjykatën që vendimet e Agjencisë ishin shfuqizuar që në vitin 2008 dhe që të drejtat e tyre të trashëguara të pronës ishin akoma në shqyrtim nga gjykatat e brendshme.

10. Kërkuesit kundërshtuan këto fakte pa mbështetur pretendimet e tyre ose pa dhënë prova në mbështetje të këtyre deklarimeve.

11. Gjykata përsëriti që koncepti i “abuzimit”, sipas kuptimit të paragrafit 3, të nenit 35, të Konventës, duhet të kuptohet si i tillë që ka të bëjë me çdo shkelje nga një kërkues që është qartazi në kundërshtim me qëllimin e së drejtës së kërkesës individuale, siç parashikohet në Konventë dhe që pengon funksionimin e duhur të Gjykatës, ose zhvillimin e duhur të proceseve përpara saj (shihni *Friedrich dhe të tjerë kundër Polonisë*, nr. 25344/20 dhe 17 të tjerë, § 122, 20 qershor 2024). Një kërkesë ka të ngjarë të rrëzohet për këtë arsye, nëse është provuar që: a) dihet se bazohet në fakte të pavërteta dhe deklarata të rreme; ose që b) informacioni dhe dokumente të rëndësishme nuk janë ndarë me dashje, qoftë kur ato kanë qenë të ditura që në fillim apo kur zhvillime të reja të rëndësishme kanë ndodhur gjatë procesit (shihni *Marjanović kundër Bosnjë Hercegovinës* (ven.), nr. 53155/12, § 18, 8 korrik 2014 dhe çështjet e cituara në të, dhe *Martins Alves kundër Portugalisë* (ven.), nr. 56297/11, § 8, 21 janar 2014). Informacion i paplotë dhe për rrjedhojë keqorientues mund të përbëjë abuzim me të drejtën për kërkesë, sidomos nëse informacioni ka të bëjë me thelbin e çështjes dhe nuk është dhënë shpjegim i mjaftueshëm për mosndarjen e këtij informacioni. Megjithatë, edhe në këto raste, qëllimi i kërkuesit për të keqorientuar Gjykatën duhet të provohet gjithmonë me siguri të mjaftueshme (shihni *Gross kundër Zvicrës* [DHM], nr. 67810/10, § 28, GJEDNJ 2014).

12. Për t'u kthyer te kjo çështje, Gjykata thekson që më 5 shtator dhe 20 nëntor 2008, zyra qendrore e Agjencisë shfuqizoi vendimet për të drejtat e trashëguara të kërkuesve dhe kthimin e tokës (shihni paragrafin 7 më lart). Kërkuesit nuk e informuan Gjykatën për këtë shfuqizim përpara se Qeveria të njoftohej për kërkesën dhe nuk u dha shpjegim për këtë mosveprim, edhe pse kishte të bënte me informacion, i cili kishte qenë në dispozicion përpara depozitimit të kërkesës në Gjykatë.

13. I vetmi argument i kërkuesve përpara Gjykatës mbi këtë çështje ishte që Qeveria kishte paraqitur deklarime të pavërteta, me qëllim shmangien e ekzekutimit të titullit të kërkuesve.

14. Megjithatë, Gjykata vëren që Qeveria paraqiti prova që vendimet administrative të 25 dhe 27 qershorit 2008 nuk janë më të vlefshme. Ky informacion, që ka lidhje drejtpërdrejt me çështjen e kërkuesve përpara Gjykatës, ishte fshehur prej tyre. Suzana Isufaj, një nga kërkueset përpara Gjykatës, kundërshtoi vendimin e Agjencisë të vitit 2013 për të rrëzuar pretendimin e tyre në gjykatë (shihni

paragrafin 8 më lart). Prandaj, kërkesit nuk mund të pretendojnë që ata nuk ishin në dijeni të shfuqizimit të vendimeve të Agjencisë në vitin 2008. Edhe nëse supozojmë që proceset e brendshme kundër vendimit të Agjencisë të vitit 2013 do të rezultojnë në favor të kërkesve, kjo nuk do të ndikonte në çështjen në fjalë, sepse do të kishte të bënte me një vendim tjetër dhe procedura të tjera ekzekutimi nga ato të ankimuar në këtë çështje. Kërkesit do të duhej të kërkonin nxjerrjen e një urdhri tjetër ekzekutimi dhe të fillonin procedura të reja ekzekutimi.

15. Heshtja e plotë e kërkesve për shfuqizimin e vendimeve të Agjencisë, ndërkohë që pretendojnë se ato vendime nuk ishin ekzekutuar, sipas Gjykatës nuk mund të interpretohet ndryshe, veçse si mosndarje informacioni në lidhje me vetë thelbin e kërkesës. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij informacioni për vendimmarrjen e çështjes, Gjykata gjen elemente të mjaftueshme për të përcaktuar që kërkesit me dashje e penguan Gjykatën që të mos kishte njohuri të plotë të fakteve të çështjes dhe që kjo sjellje ishte në kundërshtim me qëllimin e së drejtës për kërkesë individuale, siç e parashikon neni 34 i Konventës (shihni *Gross*, cituar më sipër, §§ 35–36, dhe *Gevorgyan dhe të tjerë kundër Armenisë* (ven.), nr. 66535/10, §§ 31–39, 14 janar 2020). Prandaj Gjykata gjen që kjo kërkesë përbën abuzim të së drejtës për kërkesë individuale dhe duhet të refuzohet në përputhje me paragrafin 3 (a) dhe 4 të nenit 35 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht:

Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 16 tetor 2025.

Olga Chernishova
ZËVENDESKANCELAR NË DETYRË

Úna Ní Raifeartaigh
PRESIDENT

LISTA E KËRKUESVE

Kërkesa nr. 32645/16

Nr.	Emri i kërkesit	Viti i lindjes/regjistrimit	Shtetësia	Vendi i qëndrimit
1.	Hajro ÇINI	1957	shqiptar, kanadez	Richmond Hill
2.	Liri BEGEJA	1944	shqiptare	Durrës
3.	Zhaneta BEQIRI	1955	shqiptare	Tiranë
4.	Zahide BRAHAM	1966	shqiptare, australiane	Victoria
5.	Meshan ÇINI	1928	shqiptar, kanadez	Ontario
6.	Ilir DEMIRI	1961	shqiptar, amerikan	Glendale
7.	Merita ETEMI	1972	shqiptare	Tiranë
8.	Feizi FERAIZI	1938	shqiptar	Tiranë
9.	Gjinovefa FERAIZI	1968	shqiptare, greke	Tiranë
10.	Mimoza GJIKI	1960	shqiptare, amerikane	Garfield
11.	Agron GOLJA	1943	shqiptar, kanadez	Ontario
12.	Viron HOXHA	1956	shqiptar, amerikan	Garfield
13.	Suzana ISUFAJ (ÇINI)	1962	shqiptare	Durrës

Nr.	Emri i kërkuesit	Viti i lindjes/regjistrimit	Shtetësia	Vendi i qëndrimit
14.	Liliana KALAJA	1959	shqiptare, italiane	Trieste
15.	Enkelejda PICI	1964	shqiptare, amerikane	Ridgewood
16.	Fatmir SHEHU	1975	shqiptar, gjerman	Gladbeck
17.	Fitnet SHEHU	1956	shqiptar	Durrës
18.	Mercede SHEHU	1960	shqiptare, italiane	Torino
19.	Muharrem SHEHU	1938	shqiptar	Durrës
20.	Nexhip SHEHU	1951	shqiptar	Durrës
21.	Shpëtim SHEHU	1944	shqiptar	Durrës
22.	Gëzim TIVARI	1968	shqiptar	Durrës
23.	Taulant TIVARI	1970	shqiptar, britanik	Durrës
24.	Edmond XHIKU	1956	shqiptar	Athinë